



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1029

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani si kryetare, Isa Hasani dhe Vedat Poterqoi anëtar, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik [OE] “Solid” Sh.P.K. të datës 18.12.2023 si dhe ankesën e operatorit ekonomik [OE] “Furkan Rada B.I.” të datës 18.12.2023, të parashtruara kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 29.11.2023 të Ministrisë së Mbrojtjes nga cilësia e saj si Autoritetit Kontraktues [AK] lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “RITENDER - Furnizim me Çizme ushtarake për nevoja të FSK-së” me numër të prokurimit 217-22-7705-1-1-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 08.03.2024 merr këtë:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Solid” SH.P.K. e datës 18.12.2023, me numër protokollit 2023/1029 kundër Njoftimit mbi Vendimin e Ministrisë së Mbrojtjes- Autoritetit Kontraktues i datës 29.11.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “RITENDER - Furnizim me Çizme ushtarake për nevoja të FSK-së” me numër të prokurimit 217-22-7705-1-1-1.
2. Hedhet si e palejuar ankesa e operatorit ekonomik “Furkan Rada B.I.” e datës 18.12.2023, me numër protokollit 2023/1030 e parashtruar kundër Njoftimit mbi Vendimin e Ministrisë së Mbrojtjes- Autoritetit Kontraktues i datës 29.11.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “RITENDER - Furnizim me Çizme ushtarake për nevoja të FSK-së” me numër të prokurimit 217-22-7705-1-1-1.
3. Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i datës 29.11.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën 1 dhe 2 të dispozitivit.
4. Lejohet kthimi i depozitës së paguar me rastin e parashtrimit të ankesës për ankuesit të cilët konform nenit 31, pika 6 të Rregullores së punës së OSHP, kanë të drejtë të paraqesinë kërkesë për kthimin e mjeteve, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Ministria e Mbrojtjes në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “RITENDER - Furnizim me Çizme ushtarake për nevoja të FSK-së” me numër të prokurimit 217-22-7705-1-1-1.

Me 29.11.2023 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë grupin e operatorëve ekonomik “RUNWAY SH.P.K. & GENC TAAHHUT GIYIM TEKSTIL INSAAT SAN.VE. TIC. LTD. STI VKN”.

Me 04.12.2023, OE“Solid” Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin cituar si më sipër kurse lidhur me të AK me 18.12.2023, ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim. Me datë 18.12.2023 OE ankues “Solid” Sh.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesë e cila mban numrin e protokollit 2023/1029.

Me 04.12.2023, OE“Furkan Rada B.I.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin cituar si më sipër kurse lidhur me të AK me 18.12.2023, ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim. Me 18.12.2023 OE “Furkan Rada B.I.” ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/1030.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës së OE ankues tjetër “Solid” Sh.P.K. me nr. 2023/1029, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Kurse gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës se OE "Furkan Rada B.I." Paneli Shqyrtues ka gjetur se i njëjti nuk është palë e interesuar në këtë aktivitet të prokurimit sipas definicionit të dhënë në ligjin e prokurimit publik (LPP) të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Për të qenë palë e interesuar sipas LPP, personi duhet të ketë një interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit, duke përfshirë rrezikun e dëmtimit nga një shkelje e pretenduar. Paneli ka vënë re se operatori ekonomik ishte eliminuar me vendimin paraprak të këtij intitucioni, I njëjti nuk ka arritur të kontesoj aspektin e papërgjegjshmërisë së ofertës së tij, duke e bërë të pamundur për të dëshmuar një interes material në aktivitetin e prokurimit. Si rezultat, nuk ka mundur të vazhdohet me shqyrtimin e ankesës sipas nenit 105 të LPP. Kështu, vendimi i Panelit Shqyrtues bazohet në interpretimin e definicionit të një palës së interesuar dhe në mungesën e dëshmive të nevojshme për të mbështetur pretendimet e operatorit ekonomik ankues duke u bazuar në nenin 109/A lidhur me nenin 108/A të LPP, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se nuk mund të vazhdohet me shqyrtimin e ankesës në kuptim të nenit 105 të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 2023/1029 dhe ankesa nr. 2023/1030 të bashkohen dhe të trajtohen proceduralisht si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Solid” Sh.P.K. janë parashtuar shkurtimisht si në vijim kurse te njetat gjinden me gjersësiht në parashtresën e ankuesit e cila mban numer protokollit 1029/2023:

Ankuesi pretendon se AK, ka vepruar në kundërshtim me ligjimin për prokurimin publik, pretendimi i parë ka të bëjë me pohimin e ankuesit se “testimi i mostrave të çizmeve u bë në laborator pa akreditim ndërkombëtar dhe pa marrëveshje ligjore me ministrinë, dhe si i till ky vlersim apo keto analizua nuk duhet të mirren si të mirëqena nga AK, kurse sa i përket pretendimi të dytë - ankuesi ka pohuar se operatori i rekomanduar për dhënie të kontratës është i përgjegjshëm pasi që nuk përmbush kërkesat e dosjes së tenderit, kurse pretendimi radhës ka të bëjë me pohimin se “autoriteti kontraktues nuk ka ofruar informata sipas nenit 10” duke vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7 59 dhe 60 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues në vendimin ndaj kërkesës për rishqyrtim të datës 08.12.2023, kurse ka pohuar se nuk qëndrojnë asnjë nga pretendimet e bëra nga ankuesi sepse bazuar në marrëveshjen e Autoritetit Kontraktues Ministria e Mbrojtjes dhe Universitetin Politeknik i Tiranës "Laboratori Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës te datës 27.10.2023, me Numër protokollit te AK-MM 3336 dhe me Numër protokollit te Universitetin Politeknik i Tiranës 2521. Grupi i Operatorëve Ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar te gjitha kriteret e përcaktuar ne dosjen e tenderit dhe te njoftimit për kontratë sipas LPP-së. Tutje sa i përket pretendimit nr. 2 AK ka pohuar shkurtimisht se Bazuar ne marrëveshjen cituar m cituar më sipër ne i kemi dorëzuar mostrat ne Laboratori Fiziko- Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës, kurse komisioni i Ri-vlerësimit të ofertave bazuar në vendimin e Panelit Shqyrtues, me numër protokollit 2023/0484 te datës 15.09.2023 si dhe bazuar ne Raportet e Atesteve te Laboratorit ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave në mënyrë të barabarte sepse Ri-vlerësimi i tenderëve është bërë në përputhje të plotë me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar dhe kërkesave të përcaktuar në dosjen të tenderit dhe njoftimit për kontratë si dhe Kriterit për Dhënien e Kontratës, Autoriteti kontraktues ka respektuar ne tersi LPP Grupi i OE i rekomanduar për dhënie të kontratës është i përgjegjshëm, sepse ka ofruar ofertën e përgjegjshme me çmimin më të lirë. Autoriteti kontraktues po ashtu ka sqaruar se OE i rekomanduar ka dorëzuar kërkesat e përshtatshëmërisë përkatësisht a. Vendimi i gjykatës, b. Vërtetimet tatimore sipas kërkesës se AK para vendimit mbi njoftimin e AK- se (dokumente te cilat nuk janë kërkuar nga ana juaj). Kurse të gjitha dokumentet tjera te cilat qe pretendohet qe nuk i posedon Gr. OE i rekomanduar janë pjese e ofertës me rastin e ofrimit ne sistemin e-prokurimi sipas kërkesave te përcaktuara ne Nj K dhe DT. Grupi i OE i rekomanduar për dhënie të kontratës është i përgjegjshëm, sepse ka ofruar

ofertën e përgjegjshme me çmimin më të lirë, sipas kërkesave të DT dhe të njoftimit për kontratë. Tutje për pretendimin 4 ka pohuar gjithashtu se nuk qëndron ky pretendim ngase sipas tij/saj me datë 29.11.2023, sipas kërkesës me e-mail zyrtar të OE ankues ka kërkuar qasje për Grupin e OE të rekomanduar për kontratë, kurse në me datë 30.11.2023 ju kemi dhënë qasje të plot, sipas kërkesës së tyre në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, Te bashkangjitur gjeni edhe proces verbalin e qasjes në dokumente zyrtare të nënshkruar nga OE dhe zyrtarit të prokurimit të AK.

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues, ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, kurse me datë 26.01.2023, është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimin që ankesa e OE Solid SHPK të klasifikohet si pjesërisht e bazuar, kurse aktivitet të kthehet në Rivlerësim.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Solid” Sh.P.K., eksperti shqyrtues në raportin e tij ka paraqitur vlerësimet dhe konstatimet si në vijim:

Lidhur me pretendimin e parë ankimor, eksperti ka sqaruar se ankesa kryesisht ka të bëjë me përzgjedhjen e laboratorit për shqyrtimin e këpucëve dhe materialeve në lidhje me çështjen e ngritur në pikën 2.1 të parashtrësës së tij. Eksperti shqyrtues sqaron se ka analizuar të gjitha të dhënat prezantuar në dokumentacionin teknik dhe ofertën e ofruesit ankues, kurse me kujdes të veçantë sipas tij janë trajtuar kërkesa për sqarime shtesë, të paraqitura më datë 28.09.2022, në lidhje me standardin ISO 20347, kurse ka pohuar po ashtu se sipas dispozitave ligjore dhe përgjegjësiwe institucionale, AK ka të drejtën për përzgjedhjen e laboratorit për testimin e mostrave dhe këpucëve edhe pse është kërkuar dëshmi mbi A-testin nga një laborator i akredituar, sa i përket materialeve ofertuese. Vlenë të theksohet se laboratorit kontestues sipas ankuesit në fjalë është i akredituar pikërisht për analizën e kimikës së lëkurës dhe fibrave të tekstilit nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, organi më i lartë i akreditimit në Republikën e Shqipërisë. Informacioni i dhënë në webfaqen e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (shih linkun: <https://dpa.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/UPT-Total.pdf>) që vërteton kredibilitetin e laboratorit për këtë lloj analize. Për këtë arsye, vlerësimi i vlefshmërisë së analizave mbetet përgjegjësi e laboratorit në fjalë dhe e Autoritetit Kontraktues. Është e rëndësishme të theksohet se pretendimi i OE-së ankuese lidhur me këtë çështje është i pa bazuar dhe nuk ka mbështetje në faktet dhe informacionin e prezantuar nga laboratorit”.

Lidhur me pretendimin tjetër të abkuesit Solid Shpk në lidhje me vendimin e AK në pikën 2.2, për validitetin e laboratorit të përzgjedhur, citon se e ka shpjeguar paraprakisht në pretendimin 1, ku pohon se përzgjedhja e laboratorit për testimin e materialeve dhe mostrave të prokurimit është përgjegjësi e AK. Kurse AK ka kryer këtë përzgjedhje e ka bërë duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe standartet e aplikueshme. Është e rëndësishme të përmendet se laboratorit i përzgjedhur është i akredituar nga organi më i lartë në Republikën e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, siç është shfaqur në linkun e paraqitur më lartë (<https://dpa.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/UPT-Total.pdf>). Kjo akreditim vlen deri në vitin 2025, siç tregohet në dokumentacionin fotografik të bashkangjitur. Me këto fakte në shqyrtim, për shkak të akreditimit nga një organ i njohur dhe për shkak të vlefshmërisë së tij deri në vitin 2025, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankuese është i pa bazuar”.

Lidhur me pretendimin e OE-së ankuese Solid Shpk, në lidhje me vendimin e AK në pikën 2.3, i cili ka të bëjë me çështjen e qasjes në dokumente zyrtare, duke respektuar ligjin e LPP, eksperti

shqyrtues ka analizuar me kujdes dokumentacionin e prezantuar në platformën e-prokurimit. Gjithashtu, ka pohuar se janë shqyrtuar komunikimet elektronike përmes e-mailave midis OE-së ankuese dhe AK-së në lidhje me këtë çështje. Nga komunikimet shihet se OE-së ankues iu është dhënë qasje në platformën e-prokurimit dhe një shkresë zyrtare i është dërguar më datë 30.11.2023, ku kërkohej të caktohej koha e marrjes së dokumentacionit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Në lidhje me dyshimet e shfaqura për ndonjë kontratë/marrëveshje midis AK dhe laboratorit, eksperti shqyrtues, për të vlerësuar pretendimet, ka kërkuar sqarime shtesë duke u bazuar në rëndësinë e aktivitetit. Sipas dokumentacionit të pranuar më datë 22.01.2024, vërehet se ka një marrëveshje të vlefshme mes palëve për testime të tilla. Prandaj, eksperti shqyrtues konkludon se pretendimi i OE-së ankuese, në kundërshtim me vendimin e AK në lidhje me këtë çështje, është i pa bazuar”.

Lidhur me pretendimin e OE ankues Solid Shpk, kundrejt vendimit të AK sa i përket pikës 2.4, 2.5 dhe 2.6. Pretendimi ankimor i ngritur nga ana e OE ankues, që ka të bëjë me mos plotësimin e kushteve të DT në referencë të Nenit 26, Paragrafit 6, vlefshmërisë së certifikatave ose ISO standardeve, Pas analizës së të dhënave të ofruara dhe kërkesave të paraqitura në DT, është vërejtur se në lidhje me standardet e kërkuara për cilësinë e produkteve, konkretisht çizme dimërore dhe verore, AK ka përcaktuar këtë kërkesë të kërkesat teknike e jo tek administrative, gjegjësisht përmes pikeve 9.1 dhe 9.2 të Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Si rezultat, konformë LPP dhe praktikave të mira, anëtarët e konerciumit janë në gjendje të plotësojnë njëri-tjetrin, duke pasuar se nuk janë prodhues të vetëm, por kanë formuar një konercium. Referimi i Nenit 26 nga ana e OE në këtë rast është i gabuar, me qenese se njoftimi për aktivitetin perkates eshte ber me dt.22.07.2022 ateher rregulloreja e referuar nuk ka qen ne fuqi, por eshte dashur qe te referoheni rregullores se vjeter, ndersa keto dispozita nuk kan ekzistuar, keshtu qe rrjedhimishte nuk munde te aplikohet nje rregullore ne reaktroativitet andaj pretendimi eshte i pa bazuar. Për sa i përket validitetit të certifikatave të paraqitura, është në diskrecion të AK të bëjë vlerësimin e tyre në rast se ka ndonjë dyshim. Megjithatë, nga raporti i ri i vlerësimit dhe dokumentet e ofruara, nuk ka shenja të ndonjë çështjeje të tillë. Prandaj, eksperti shqyrtues, lidhur me këtë çështje, vlerëson se pretendimi ankimor i OE-së ankuese është i pa bazuar”.

Lidhur me pretendimin e ankuesit, kundrejt vendimit të AK sa i përket pikës 3.1 lidhet me mos-përmbushjen e kërkesave në DT. Eksperti shqyrtues sqaron se pas analizës së fakteve të paraqitura në ofertën e OE-së së rekomanduar, ka vë në dukje se OE e rekomanduar i ka plotësuar kërkesat e paraqitura në DT, veçanërisht të kërkuara si në paragrafin 6.4 dhe 11.11. Në ofertën paraqitur, është evidentuar se janë deklaruar të gjitha informacionet e kërkuara në përputhje me DT, duke përfshirë deklaratën nën betim të dy anëtarëve të konerciumit, të paraqitur në dokumentet "Aneksi 2Deklarata nen betim e turkut Genc.pdf" dhe "Aneksi 2 DEKLARATA NN BETIM runway shpk.pdf". Po ashtu, pjesë e ofertës është deklarata e caktimit të liderit dhe mos-pjesëmarrjes në ndonjë konercium tjetër për këtë aktivitet të prokurimit, e paraqitur në dokumentin "Konzorciumi Runway shpk.pdf". Bazuar në shpjegimet e mësipërme, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor i OE-së ankuese kundër vendimit të AK lidhur me këtë çështje është i pa bazuar. Informacioni dhe dokumentacioni prezantuar në ofertë tregojnë se OE ka respektuar dhe plotësuar kërkesat e DT, dhe, kështu, vendimi i AK është marrë me bazë dhe në përputhje me faktet e prezantuara”.

Lidhur me pretendimin e OE ankues Solid Shpk, kundrejt vendimit të AK sa i përket pikës 3.2 - Pretendimi i OE-së ankuese në këtë çështje ka të bëjë me mosplotësimin e kërkesave të përputhshmërisë nga ana e OE-së së rekomanduar. Pas administrimit të fakteve të prezantuara në

ofertën e OE-së së rekomanduar, eksperti shqyrtues vë në dukje se konsorciumi i përbërë nga dy OE ka paraqitur certifikatat e biznesit dhe numrit fiskal sipas kërkesave të DT. Sa i përket kërkesave në paragrafin 6.4, specifikisht kërkesës 2 dhe kërkesës 3, këto dokumente janë kërkuar të plotësoheshin nga OE e rekomanduar ose tenderuesi fitues para publikimit të dhënies së kontratës. Në lidhje me certifikatat për TVSH-në dhe atë të numrit fiskal, është evidente që ato mungojnë në ofertën e OE-së së rekomanduar. Megjithatë, sipas udhëzuesit me nr. 001/2023 për prokurimin publik dhe në përputhje me Nenin 66 të LPP-së, AK ka pasuar mundësinë të kërkojë këto dokumente gjatë periudhës së ekzaminimit të tenderit. Prandaj, pretendimi ankimor i OE-së ankuese kundër vendimit të AK në këtë çështje mendohet se është pjesërisht i bazuar”.

Lidhur me pretendimin e OE ankues Solid Shpk, kundrejt vendimit të AK sa i përket pikës 3.3 Pretendimi ka të bëjë me çështjen e vlerës monetare të qarkullimit bankar. Pas administrimit të dokumenteve të paraqitura në ofertën e OE-së së rekomanduar, eksperti shqyrtues, në lidhje me dëshminë e qarkullimit, vlerëson se dokumenti është paraqitur në gjuhën turke, është i vulosur dhe i përkthyer, një ashtu vulosur përkthimi dhe përmban disa fleta që kanë të bëjnë me vlera tjera pos lirës turke, siç vlera në dollar dhe euro, megjithatë bazuar në dokumentin e prezantuar plotëson kërkesën e DT. Si do të jetë, është e rëndësishme të theksohet se vlerësimi i vlerës së këmbimit të valutës është bërë me një kalkulim të gabuar, pasi është marr si referencë vlera aktuale e këmbimit, Kjo vlerë do të duhej të shikohet në kohën e mbylljes së vitit fiskal për vitet 2022, 2021 dhe 2020, siç është shkruar në dokumentin e dorëzuar, dhe jo si një vlerë aktuale e këmbimit. Prandaj, pretendimi ankimor i OE-së ankuese kundër vendimit të AK në lidhje me këtë çështje është i pa bazuar”.

Lidhur me pretendimin e OE ankues Solid Shpk, kundrejt vendimit të AK sa i përket pikës 3.4, 3.5 dhe 3.6 - Këto pretendime ankimore lidhen me çështje të specifikimeve teknike, të kërkuara në DT. Pas administrimit të dokumenteve në ofertën e OE-së së rekomanduar dhe duke shqyrtuar katalogun e produkteve, eksperti shqyrtues vë në dukje se, sipas katalogut të paraqitur nga OE e rekomanduar, nuk plotësohen kërkesat e theksuara në DT për çështjet e ngritura në pikën 3.4, 3.5 dhe 3.6. Përkatësisht, çizmet e ofruara nuk kanë sistem të shpejtë të lidhjeve dhe kanë tejkaluar Hi mbi 9% sipas standardit EN ISO 4047 1998. Në të njëjtën kohë, pesha e shtresës së sipërme të çizmeve dimërore është më e madhe se pesha e kërkuar, duke devijuar nga specifikimet e lejuara sipas DT. Meqenese devijimi në parim nuk është i madhe, mbetet në pergjegjesi dhe diskrecion të AK aplikimi i nenit 59.2. Prandaj, në lidhje me këtë çështje, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar”.

Lidhur me pretendimin e OE ankues Solid Shpk, kundrejt vendimit të AK sa i përket pikës 4.1, 4.2 dhe 4.3 - Pretendimet e tilla lidhen me çështjen e qasjes në dokumente publike, duke marrë parasysh se kjo çështje është trajtuar më lart, përmes administrimit të të dhënave në këtë aktivitet të prokurimit sipas dëshmive në e-prokurim dhe e-mailave të shkëmbyer. Nga shqyrtimi i këtyre dëshmive, duket se AK i ka dhënë qasje dhe ka kërkuar nga OE ankues të marrë të gjithë dokumentacionin që është pjesë e këtij aktiviteti dhe është zhvilluar përmes këtij kodi të prokurimit me anë të platformës e-prokurimi. Bazuar në këtë, mendoj se AK ka respektuar Ligjin e Prokurimit Publik sa i përket qasjes në dokumente publike që lidhen me këtë aktivitet. Në lidhje me çështjen e kontratës ndërmjet laboratorit dhe AK, mendoj se me të drejtë AK ka kërkuar që qasja të bëhet përmes një kërkesë të veçantë, siç parashihet në ligjin për qasjen në dokumente publike 06/L-081. Kjo është jashtë diskrecionit të Ligjit të Prokurimit Publik, pasi kontrata e lidhur mes dy entiteteve nuk është pjesë e kësaj procedure të prokurimit. Prandaj, bazuar në këtë, eksperti shqyrtues mendojnë se pretendimi ankimor është i pabazuar. Vlene të theksohet një çështje kyçe, që është e evidentuar përgjatë analizimit dhe shqyrtimit të ankesës

relevante, lidhur me kete aktivitet OE ankues eshte eliminuar per aresye si ne vijim: duke qene se OE ankues ka ngritur pretendime lidhur me analizat laboratorike, nuk eshte evidentuar se ne ankesen e tij, i njejti ka kundërshtuar te gjeturat e komisionit vlersues”.

AK sipas përgjigje ndaj raportit të ekspertit ka kërkuar nga paneli që Ankesën e OE ankues ta refuzoj në tërësi si të pabazuar dhe të mbetet ne fuqi vendimi i AK sepse i njëjti është i papërgjegjshëm bazuar ne Raportet e Atesteve te Laboratorit kurse sa i përket OE të rekomanduar i njëjti ka ofruar certifikatën e regjistrimit të biznesit nr. 811946592 dhe nëpërmjet numrit unik identifikues mund të merren të gjitha të dhënat detale në ARBK për të gjithë OE duke përfshirë edhe OE të rekomanduar për kontratë. Sa i përket pretendimeve për çizme “lidhje të shpejt” i cilësuar si pjesërisht i bazuar nga eksperti, ju njoftojmë se mostra e OE të rekomanduar është në përputhje me specifikat dhe kërkesat e DT sepse mostra e çizmeve i ka kaluar të gjitha testet sipas kërkesave të përcaktuara në Ankesin 1 të DT nga laboratorit ku janë dërguar nga AK për testim.

Shkurtimisht OE ankues ka deklaruar në përgjigje ndaj raportit te eksperti se se nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues sepse i njëjti ka kontaktuar gabimisht gjendjen faktike, nuk ka trajtuar te gjitha pretendimet ankimore dhe ka tejkaluar autorizimet ligjore ne lidhe me menyren se si ka trajtuar pretendimet ankimore nga si te tilla te gjitha pohimet qendrojnë sepse sipas tij/saj testimi i mostrave është bërë nga laboratorit pa akreditim nderkombatar dhe pa marrevhesje ligjore, nuk ka kontratë me këtë laborator AK, mungojnë ISO certifikatat nga lideri i konsorciumit, dhe se marrveshja e konsorciumit nuk i ka elemente e DT nuk ka deklaratë se të gjithë anëtarët personalisht dhe bahskarisht janë përgjegjës për zbatimin e kontratës . po ashtu mungon deklarata se anëtarët nuk apilokjnë individualisht në ndonjë konsorcium tjetër për këtë aktivitet dhe i mungon autorizimi dhe deklarata e liderit te grupit, Oe nuk ka plotësuar qakullimin financiar dhe nuk ka plotësuar kriteret teknike sipas DT.- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, ka vlerësuar të gjitha provat në shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se autoriteti kontraktues në rastin konkret nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat sikurse është pohuar nga ankuesi. Në të vërtetë, duke ju referuar raportit të ekspertit shqyrtues, dokumenteve të dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të administruara, Paneli Shqyrtues vëren se konstatimi i ekspertit shqyrtues sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me pikën 3.2 [cituar në raportin e ekspertit shqyrtues] nuk e ka ndryshuar dhe nuk ka ndikim substancial në rezultatin e aktivitetit të prokurimit, kurse AK (në përgjigje ndaj raportit) ka pohuar mes tjerash se numri i certifikatës ka qene i verifikueshëm edhe ne baze te numrit unik te biznesit në faqen zyrtare të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare.

Nga ana tjetër, Paneli Shqyrtues pajtohet vetëm pjesërisht me vlerësimet e ekspertit shqyrtues të pretendimeve ankimore lidhur me pikat 3.4, 3.5 dhe 3.6. të cilat i cilëson si kundërtënëse pasi që në njërin anë eksperti konstaton se bëhet fjalë për devijime të vogla të cilat nuk kanë ndikim në rezultatin e aktivitetit të prokurimit, ndërsa në anën tjetër të njëjtat pretendime i vlerëson si të bazuara. Përdërisa sa i përket pretendimeve të tjera ankimore, Paneli Shqyrtues pajtohet në tërësi me vlerësimet dhe analizat e ekspertit shqyrtues.

Lidhur me pohimet e ankuesit sa përket qarkullimit financiar të OE të rekomanduar për kontratë, paneli shqyrtues e mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili mes tjerash ka konstatuar se dokumenti është paraqitur në gjuhën turke por është i vulosur dhe i përkthyer në gjuhën shqipe.

Sipas raportit të ekspertit shqyrtues konstatohet po ashtu se kalkulimi i vlerës së këmbimit të valutës është bërë në mënyrë të gabuar nga ankuesi pasi është marr si referencë vlera aktuale e këmbimit, ndërsa kjo vlerë do të duhej të analizohej në kohën e mbylljes së çdo viti fiskal, për vitet 2022,2021 dhe 2020 siç është prezantuar në dokumentin e dorëzuar nga OE i rekomanduar, andaj eksperti me të drejtë këtë pretendim të ankuesit e ka kualifikuar si të pabazuar.

Sa i përket pohimeve të ankuesit, lidhur me ISO standardet nga lideri i grupit, paneli vlerëson se me të drejtë eksperti shqyrtues ka konstatuar se në kohën e inicimit të këtij aktiviteti të prokurimit, Rregullorja Nr.001/2022 së cilës i referohet ankuesi nuk kanë qenë akt në fuqi, përderisa e njëjta është aprovuar dhe publikuar me 01.11.2022. Lidhur me këtë, nenit 56.3 të LPP parashihet se, tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në bazë të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, duke shpjeguar po ashtu në këtë rast se aktet nënligjore nuk kanë kenë efekt prapaveprues, ashtu siç ka pohuar ankuesi. Paneli gjate administrimit të parashtresës së ankuesit dhe po ashtu në përgjigjen e tij/saj ndaj raportit të ekspertit shqyrtues ka hasur në dy pretendime përkitazi me “marrëveshjen e konsorciumit” mes anëtarëve të GOE të rekomanduar për kontratë, gjoja se e njëjta nuk i përmban elementet e kërkuara sipas dosjes së tenderit, sepse sipas tij/saj mungon deklarata se të gjithë anëtarët personalisht dhe bashkërisht janë përgjegjës për zbatimin e kontratës, mungon deklarata se anëtarët nuk aplikojnë individualisht në ndonjë konzorcium tjetër për të njëjtin aktivitet të prokurimit dhe mungon autorizimi dhe deklarata për autorizim të liderit të grupit për këtë aktivitet të prokurimit. Pohime të tilla sipas konstatimit të ekspertit dhe verifikimit në ofertën e OE të rekomanduar rezultojnë si jo të vërteta. Në rrethana të tilla paneli është i detyruar të informoj ankuesin se ka të drejtë të shqiptoj masa administrative. konfom nenin 31 paragrafi 7, të Rregullores së Punës së OSHP-së, nëse konstatohet se cilado nga pretendimet e bëra në ankesë janë të rrejshme.

Në kontekstin e pohimeve ankimore eksperti shqyrtues ka konstatuar se ankuesi nuk ka parashtruar pretendime përkitazi me analizat laboratorike duke shtuar me tej se nuk i ka kundërshtuar as të gjeturat e komisionit vlerësues të AK. Megjithatë, paneli ka vërejtur se ankuesi sipas parashtresës së tij/saj nr. protokolli 1029/2023, ka ngritur disa shqetësime në lidhje me laboratorin e përdorur për analizat, duke sugjeruar se ky laborator nuk është zgjedhur në përputhje me ligjin për prokurimin publik, nuk ka marrëveshje valide mes AK dhe laboratorit, nuk ka licencën ndërkombëtare për të kryer analizat cilësore sipas standardeve të kërkuara dhe ka dyshime për kredibilitetin dhe besueshmërinë e tij, siç është dokumentuar në një vendim të OSHP nga viti 2018. Në anën tjetër, eksperti shqyrtues në raportin e tij konfirmon se laboratorin i diskutuar ka një akreditim të vlefshëm nga autoritetet përkatëse në vend, dhe informacioni për këtë mund të verifikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, eksperti ka siguruar një lidhje të internetit që vërteton kredibilitetin dhe besueshmërinë e këtij laboratorin për analizën e specifikuar.

Lidhur me këtë paneli sqaron se duke e përmendur faktin se një vendimi i OSHP-së i vitit 2018 i cili sipas ankuesit ngre dyshime mbi besueshmërinë dhe kredibilitetin e po këtij laboratorin, paneli sqaron se përtej kësaj ka kaluar një periudhë prej gjashtë vitesh dhe është e rëndësishme të theksohet se në këtë periudhë mund të ketë ndryshime të ndjeshme në kushtet dhe standardet e laboratorit. Përveç kësaj, është e rëndësishme të theksohet se paneli shqyrtues në asnjë rrethanë nuk bënë interpretimin e vendimeve të mëparshme të këtij institucionit, pasi që çdo rast i shqyrtuar me ankesë ka karakteristikat dhe kontekstin e tij të veçantë dhe nuk përdoren si provë vendimet dhe/ose faktet apo provat e një vendimi në raport me një vendim tjetër. Dhe përveç tjerash, OSHP nuk ka kompetencë apo autoritet të mohojë dhe/ose të konfirmojë kredibilitetin e

një institucioni të akredituar, sepse autoritetet kompetente të cilat i akreditojnë laboratorët e tilla sipas procedurave të vlefshme, kanë për detyrë të vlerësojnë nëse përmbushin apo jo standardet e nevojshme për të ofruar shërbime cilësore dhe të besueshme në fushën e tyre të specializuar. Nga ana tjetër ashtu siç u citua më sipër nga eksperti shqyrtues laboratorit rezulton të jetë i akredituar nga autoritet relevante dhe një gjë e tillë mund të verifikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit në Republikën e Shqipërisë, kurse sa i përket pretendimit të ankuesit se nuk ka marrëveshje valide ndërmjet AK dhe Laboratorit, AK ka pohuar Marrëveshje ekziston në mes të Autoritetit Kontraktues Ministria e Mbrojtje dhe Universitetin Politeknik i Tiranës "Laboratori Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës duke cituar datën 27.10.2023, dhe Numrin e protokollit të AK-MM 3336 dhe të Universitetin Politeknik i Tiranës 2521.

Sa i përket plotësimit të kërkesave të specifikacionit teknik në DT nga Ankuesi, sipas rezultateve të laboratorit të cituar si më sipër ka rezultuar se pothuajse të gjitha specifikat për të dyja çizmet verore/dimërore nuk i plotësojnë kërkesat e vendosura nga AK në DT. Në fakt, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi/provë bindëse nëse i njëjti i plotëson apo jo kriteret e DT por ka pohuar se AK ka bërë zgjedhje të gabuar të laboratorit dhe se aktiviteti do duhej të kthehej në rivlerësim.

AK, ka shpjeguar se bazuar në Raportet e Atesteve të Laboratorit është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave në mënyrë të barabartë dhe në harmoni me LPP dhe kërkesat dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, nga të cilat ka rezultuar se Grupi i OE i rekomanduar për dhënie të kontratës është i përgjegjshëm, sepse ka ofruar ofertën e përgjegjshme me çmimin më të lirë ngase i ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuar në dosjen e tenderit dhe të njoftimit për kontratë sipas LPP, në krahasim me ofertën e ankuesit e cila nuk i plotëson të gjitha kërkesat e AK. Paneli shqyrtues thekson se në këtë rast duhet kujtuar se autoriteti kontraktues nga cilësia e tij si institucion i administratës publike ka kapacitetet organizativ dhe profesional dhe ka të drejtë që ta themelojë komisionin vlerësues i cili është përgjegjëses për procesin e vlerësimit të tenderëve, sikurse kërkohet kjo shprehimisht në paragrafin 1 të nenit 59 të LPP-së. Kurse sipas nenit 24 të ligjit të cituar "autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" e duke vazhduar me kujdesin e tij/saj në implementimin e drejtë të dosjes së tenderit dhe siç kërkohet me dispozitën e nenit 59 të LPP "të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"

Lidhur me ankesa e operatorit ekonomik "Furkan Rada B.I." e njëjta është hedhur poshtë si e palejuar andaj e njëjta nuk është përfshirë në procesin e shqyrtimit meritore, pasi që me vendimi paraprak të po këtij Institucioni Nr. 484/486-2023 ishte konstatuar se ankuesi "Furkan Rada & Ozkan Kundura ve lastik Imalat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi" i cili ishte rekomanduar për kontratë sipas vendimit të AK të datës 28.10.2022, nuk e kishte prezantuar në ofertën e tij/saj "deklaratën për specifikacione teknike" e cila ishte kërkuar shprehimisht në DT 19.1 (h). Paneli sipas vendimit paraprak sqaroi se lidhur me kërkesat e vendosura në pikën 19.1 në Dosjen e Tenderit të cilat janë të ndryshme dhe të ndara për specifikacionet teknike konsistojnë si në vijim:

1. OE është i obliguar që të beje plotësimin, nënshkrimin, dhe vulosjen e aneksit 1 specifikimit teknik i detyrueshëm, dhe mos plotësimi i aneksit 1, sipas kërkesave do të eliminojë nga vlerësimi i mëtutjeshme.." të cilën OE i rekomanduar e kishte plotësuar. Kurse po OE ashtu do duhej të plotësonte edhe kërkesën vijuese,

2. Deklaratë me shkrim për specifikacionet teknike” mirëpo OE i rekomanduar nuk e kishte plotësuar deklaratën me shkrim.

AK kishte kërkuar sqarime nga ofertuesi tani “i rekomanduar” gjatë fazës së rivlerësimit të cilat veprime bien në kundërshtim me nenin 72 të LPP lidhur me nenin 38 RRPP, duke ju referuar po ashtu edhe interpretimit të KRPP të datës 01.06.2021, cituar “...Kurdo që kërkohet Deklarata për specifikime teknike në FDT të DT, ajo duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e tenderit...”

Mbi bazën e të lartcekurave paneli konstatoj po ashtu se, OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij fare nuk kishte prezantuar A-testet por vetëm një “katalog” e cila në përmbajtje kishte rezultate të testimit, mirëpo nuk kishin ofruar asnjë dëshmi (as OE dhe as AK) se të njëjtat ishin bërë nga një laborator i akredituar. Andaj OSHP kishte konstatuar përfundimisht se i rekomanduari mbi bazën e të lartcekurave dhe në konsistencë me vendimeve paraprahe të OSHP, 392, 485/23-511/23, ishte cilësuar si i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit, dhe të njetit i mungon statusi i palës me interes juridiko-material sikurse kërkohet kjo në kuptim të nenit 4 pragrafi 1.26 të LPP- sipas së cilit cituar: “pale me interes konsiderohet personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”.

OSHP sqaron se çdo herë që publikohet njoftimi për kontratë nga ndonjë autoritet kontraktues, palët e interesuara kanë të drejtë ti kundërshtojnë kriteret e vendosura në Dosje të tenderit [DT] para autoriteteve kontraktuese [AK] dhe në shkallë të dytë pranë organit Shqyrtues të Prokurimit [OSHP], në të kundërtën nëse palët pajtohen me dosjen e publikuar dhe nuk bëjnë kundërshtime, ato janë të obliguara të paraqesin ofertën e tyre në përputhje të plotë me kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK) e cila pastaj obligohet të veproj sipas nenit 59.4 cituar “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Përfundimisht bazuar në vlerësimin e tij, paneli pati parasysh se AK në kuptim të nenit 59.4 të LPP-së ka të drejtë të cilësojë ndonjë devijim në ofertat e ofertuesve si “devijim i vogël” tutje pati parasysh faktin që ky aktivitet i prokurimit është iniciuar në vitin 2022 dhe i njëjti ka qenë subjekt i disa ankesave në Organin Shqyrtues të prokurimit dhe ka qenë përcjellë në procedurë rivlerësimi dy here pranë AK. Andaj paneli shqyrtues ka vendosur ti japë të drejtë në këtë rast Ministrisë së Mbrojtjes nga cilësia e saj si AK, dhe të mbajë në fuqi vendimin e saj. Ky vendim mes tjerash bazohet edhe në nenin 1 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) me qëllim që të parandalohet zgjatja e aktivitetit të prokurimit në pafundësi dhe të sigurohet një zgjidhje sa më efektive për nevojat e Furnizimit me Çizme Ushtarake për nevoja të Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK).

-Përfundim-

Pas administrimit dhe vlerësimit të provave si dhe konstatimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka arritur në përfundim se ankesa e operatorit ekonomik "Furkan Rada B.I." duhet hedhur poshtë si e palejuar, pasi ky operator sipas vendimeve paraprahe të këtij organi është konsideruar i papërgjegjshëm për këtë aktivitetin të prokurimit, andaj ankesa e të njëjtit nuk është përfshirë në procesin e shqyrtimit dhe vendosjes meritore. Kurse ankesa e OE "Solid" SHPK është aprovuar si pjesërisht e bazuar pasi që nisur nga shpjegimet si më sipër janë

evidentuar disa devijime në specifika, në raport me ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar të cilat sipas AK janë konsideruar si devijime të vogla, për të cilat pajtohet edhe ky panel, meqë të njëjtat lejohet në kufijtë e autorizimeve të cilat ligjdhënësi ja njeh autoritetit kontraktues sipas nenit 59.4 të LPP-së, sipas të cilit devijimet e tilla nuk shkaktojnë ndryshime materiale, që do të thotë të njëjtat nuk e atakojnë përmbajtjen e dosjes së tenderit. Andaj dhe në bazë të kësaj, paneli ka vendosur që tarifat e depozituara nga ankuesit të kthehen, duke pasur parasysh që të gjithë ofertuesit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë.

Paneli sqaron po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjithë ofertuesit eventual, secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit, kurse kthimi i një aktivitetit të prokurimit në mungesë të provave jo kontestuese nuk ofron bazë ligjore për ri-vlerësim eventual të tij dhe nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP. Në fakt synimi i këtij aktiviteti të prokurimit i referohet dhe nenit 104 paragrafi 4 i LPP, sipas të cilit në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në këtë Pjesë IX, OSHP duhet (i) të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik përderisa po ky aktivitet i prokurimit i është nënshtruar dy here procesit të rivlerësimit.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 1,6, 104 paragrafi 1 dhe 4 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën 1, 2 dhe 3 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën 3 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur mund ti drejtohet Gjykatës Komerciale-Departamenti për çështje asministrative për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTERIA E MBROJTJES**
- **OE - Solid SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: